



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR “SHËNJTA MARI” MIRDITË

Nr.Prot. _____

Rrëshen, më _____._____.2023

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Kite dhe Reagente per Nevojat e Spitalit Mirdite

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Artikuj farmaceutik

VLERA E FONDIT LIMIT: : 1.682.140.00 (njemilion egjashteqindtetedhjetedymijeeneqind e dyzet)leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Spitali Mirditë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ne objektin e veprimtarise se Operatorit ekonomik te jete parashikuar prodhimi ose tregtimi i kite dhe reagenteve. Kjo pike vertetohet nepermjet ekstraktit te QKR.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a dhe 2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;...2. **Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.**”

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë detyrimin ligjor të liçencohen nga QKB-ja, duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, të cilët në fushën e veprimtarisë duhet të kenë të përfshirë objektin e prokurimit.

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së produkteve në mënyrë të qëndrueshme (ISO 9001), si dhe garantimin e sigurisë ushqimore në zinxhirin ushqimor që kryen ofertuesi (ISO 22000), duke qënë se cilësia dhe siguria e produktit lidhet ngushtë me objektin e prokurimit.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, kualifikimeve dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë në lidhje me garantimin e zbatimit në veprimtarinë e tyre të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vertetim per xhironushtrimorete 3 vitevefundit nga data e hapjessëofertavetëtenderit, papërvitet 2020, 2021, 2022. Vleramesatare e xhirossëkëtyretre viteveduhettëjetënëmasën 40% tëvlerësse fondit limit per lot/et te objektit te prokurimit per te cilin ofertuesi konkuron, te leshuar nga Dega e tatim

Taksave.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:
c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, jo më pak se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuajduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% të vlerës së fondit limit për lot/et, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

- *Si dëshmi për përvojën e mëparshme me institucione shtetërore kërkohen kontrata e shoqëruar me vërtetim realizim të kontratës të lëshuar nga një ent publik ose faturatimore të shitjes, kushënohendatat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohet vetëm faturatimore të shitjes kushënohendatat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

Permbushja e njerit prej kriterëve të mesipër më ben oferten të vlefshme

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë origjinin e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën nr.1 të DST formulari të ofertes).

2.3.3 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2008 ose 9001:2015 për distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore dhe reagenteve laboratorike. Përkëtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

2.3.4. Një dokument, Autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për tregëtim/shitje për artikujt e ofruar objekt prokurimi (të përkthyer dhe të noterizuar).

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të deklarohet që artikujt e ofruar janë të përshtatshme për përdorim për aparaturat që disponon Spitali Mirditë.

2.3.6: Certifikate konformiteti CE për kitet dhe reagentet e prodhuesit të mallrave të ofruar.

2.3.7 Deklaratqë Afati i skadencës për artikujt e ofruar në ditën e levrim të mallit duhet të jetë jo më i vogël se 12 muaj

2.3.7.1 Ofertuesit e ketetepunësuar në inxhinier Klinik të trajnuar për pajisje mjekësore të cilet do të jetë përgjegjës për programimin e pajisjeve laboratorike me reagentet e ofruar, dhe trajnimin e personelit përdorues. Lidhur me ketepike ofertuesit duhet të paraqesë:

- ✓ Diplomat
- ✓ Kopje të listës së pagesave për tremujorin e fundit

2.3.8 Ofertuesi duhet të paraqesë kataloget e markuar për mallrat objekt prokurimi, me të dhënat teknike ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollesishme për secilin artikull.

(Katalogët duhet të garkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST).

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor, dokumentet e mëposhtme:

- ✓ Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1 të DST
- ✓ Kandidati/ofertuesit duhet të dorëzojë:

2.3.8 Kërkesa të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rreshen, të mbyllura me ngjyese në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit me objekt: Blerje Kite dhe Reagente për Nevojat e Spitalit Mirditë dhe jo para datës 17.07.2023, ora 10 :00.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).

- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në

rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushes për keto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Vertetimet e cituar me sipër për shlyerjen e

detyrimeve duhet të jenë të drejta dhe të besueshme në të njëjtën mënyrë si të tjerat të kërkuara në kërkesën e ofertimit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues do të bejë edhe kolaudimin e aparaturave që disponon sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentacionin e ofertimit.

Afati i lëvrimit të mallit është 5 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesin të dhënat e plotatë personit të kontaktit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Lloji i Materialit	Paketimi	Specifikime dhe paketime	Njesia	Njesia	Sasia
	Kite Blood Cell Counter					
1	ABX MINICLEAR	1x1L	1 L	shishe	shishe	10
2	ABX MINI DIL LMG BP	1x10L	10 L	shishe	shishe	28

	7290					
3	ABX MINILYSER LMG	1x1L	1 L	shishe	shishe	10
4	Glukose	6X100ML	Enzymatic,colorimetric method(GOD,POD,PAD)reagent R1+standart	litra	kite/ kuti	19
5	Azotemia Urea Uv	4X62.5ML	BERTHELOT	litra	kite/ kuti	30
6	Kreatinine	2X125ML	JAFFE PICRATE ALKALINE	litra	kite/ kuti	30
7	Amilaze	1X50ML	GAL G2 - CNP, 120 ml	ml	kite/ kuti	25
8	Trigliceride	6X100ML	Lipoprotein Lipase - Glycerol Kinase, Glycerol Phosphate Oxydase / TRINDER	litra	kite/ kuti	10
9	Kolesteroli	6X100ML	Cholesterol Esterase / Cholesterol Oxidase / TRINDER	litra	kite/ kuti	10
10	Acidi Urik	5X60ML	Enzymatic,colorimetric method 2reagente R1,R2+standart	litra	kite/ kuti	20
11	ALT/GPT	4X62.5ML	IFCC	litra	kite/ kuti	30
12	AST/GOT	4X62.5ML	IFCC	litra	kite/ kuti	25
13	Methanaol	1X1L		litra	kite/ kuti	2
14	Tub me Heparin Li 2.5ml	2.5ML	tuba 12x86mm-2,5ml	cope	cope	2500
15	Tub me K3EDTA 1 ml	1ML	1 ml	cope	cope	5000
16	Tuba qelqi	12X75ML	5 ml	cope	cope	1000
17	Tuba plastik (nje perdorim)	5ML	5 ml	cope	cope	40000
18	Pipeta eritrosedimenti (nje perdorim)	1X250 cope		cope	cope	30
19	Tips Yellow 5-100ul Ependorf Type	1x1000 cope	qese x1000cope, 0-200 µL	pako	pako	40
20	Tibs Blue 100- 1000ul Ependorf Type	1x500 cope	qese x1000cope,100-1000 µL	pako	pako (60*500)	30
21	Iron	200 ML + standart	KITE	ml	kite/ kuti	9
22	Protein Totale	2X125ML	KITE	ml	kite/ kuti	4
23	LDH	2X62.5ML		ml	kite/ kuti	2
24	Gimsa	1X1L		L	L	1
25	Bilirubine totale	2X125ML	JENDRASSIK	ml	kite/ kuti	4
26	Bilirubine direkte	2X125ML	JENDRASSIK	ml	kite/ kuti	4
27	CALCIUM TOTAL	2X125ML	ml (4*125)	ml	kite/ kuti	5
28	Acid Sulfosalicilik	kg	shishe 1000gr	Kg	KG	1
29	FAL (fosfataza alkaline)	2X125ML	kuti x250 ml	ml	kite/ kuti	2

30	YGT (GGT)	2X62.5ML	kuti x125ml	ml	kite/ kuti	2
31	CRP Turbo Latex fastometer	1x40+1x10 ml		ml	kite/ kuti	10
32	Tuba citrat Na/-2,5 ml	3.8/2.5 ml		ml	cope	2000
33	Tuba me gel	5 ml		ml	cope	8000
34	Tub plastik konik per urinat	12 ml		cope	cope	8000
35	STRIPS-URINE-12	paketimi (1x100)		cope	cope	20

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar kërkeses, shkresa **Nr.Prot. 637, datë. 29.06.2023.**

3 “Relacion për përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike...” dërguar nga Komisioni për Përcaktimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike/ Spitali Mirditë, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të **jetë data 17.07.2023, ora 10.00**, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Drane Totraj
(Person Përgjegjës)

Dila Pikuli
(Anëtar)

Pjeter Ndoj
(Anëtare)
